

OJQ “ Qendra Kosovare për Studim të Sigurisë “- Prishtinë
Raporti i Auditorit të Pavarur dhe Pasqyrat Financiare
për vitin që ka përfunduar më 31 Dhjetor 2015

Qershor / 2016

Përmbajtja

RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR	3-4
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	5
PASQYRA E TË ARDHURAVE GJITHËPËRFSHIRËSE	6
PASQYRA E RRJEDHËS SË PARASË.....	7
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË EKIUTET	8
SHËNIMET E PASQYRAVE FINANCIARE	9-12



RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR

Për bordin e OJQ "Qendra Kosovare për Studim të Sigurisë"- Prishtinë

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të bashkangjitura OJQ "Qendra Kosovare për Studim të Sigurisë"-Prishtinë (Organizata), që përfshijnë Pasqyrën e pozicionit financiar më 31 Dhjetor 2015, Pasqyrën gjithëpërfshirëse e të ardhurave, Pasqyrën e rrjedhjen e parasë dhe pasqyrën e ndrrimeve në ekuitet, për vitin që ka përfunduar dhe përmbledhjen e procedurave kontabël dhe shënimeve tjera shpjeguese.

Përgjegjësia e menaxhmentit për pasqyrat financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përpilimin dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiarë në përputhje me Standardet Kosovare të Kontabilitetit. Kjo përgjegjësi përfshinë: dizajnimin, implementimin dhe mirëmbajtjen e kontrolleve të brendshme relevante për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare të cilat janë pa gabime materiale, qoftë për shkak të gabimeve dhe mashtrimeve, përzgjedhjen dhe aplikimin e politikave të përshtatshme kontabël, si dhe realizimin e vlerësimeve kontabël që janë të arsyeshme në rrethana të caktuara.

Përgjegjësia e Auditorit

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi pasqyrat financiare duke u bazuar në auditimin tonë. Ne kemi bërë auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë përputhshmëri me kërkesat etike si dhe planifikimin dhe kryerjen e auditimit për të arritur siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare janë pa gabime materiale.

Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të siguruar prova për shumatat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, përfshirë vlerësimin e riskut të gabimeve materiale të pasqyrave financiare, qoftë si rezultat i mashtrimit ose gabimit. Në kryerjen e këtyre vlerësimeve të riskut, auditori merr parasysh kontrollet e brendshme relevante për përgatitjen dhe prezantimin korrekt të pasqyrave financiare nga ana e entitetit në mënyrë që të dizajnohen procedurat e auditimit që janë të përshtatshme për ato rrethana, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit në efikasitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit. Auditimi po ashtu përfshinë vlerësimin e përshtatjes së politikave të përdorura kontabël si dhe arsyeshmerinë e vlerësimeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, gjithashtu dhe vlerësimin e prezantimit të përgjithshëm të pasqyrave financiare

Ne besojmë se përveç çështjeve të cekur më poshtë, dëshmitë e auditimit që neve i kemi siguruar janë të mjaftueshme dhe të duhura të ofrojnë bazë për opinionin tonë.



Opinion I pa kualifikuar

Sipas mendimit tonë, pasqyrat financiare të bashkangjitura japin një pamje të vërtetë dhe të drejtë, në aspektin material pozitën financiare të **OJQ " Qendra Kosovare për Studim të Sigurisë " - Prishtinë** me 31 Dhjetor 2015, performancën e saj dhe rrjedhës së parasë për periudhën që ka përfunduar me atë datë në përputhshmëri me *me Standartet Nderkombëtare të Raportimit Financiar – SNRF*.

ETIKA
Prishtina, Kosovë
Qershor 2016

Spatmelum

